



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade



API

Agjencia për Pronësi Industriale
Agencija za Industrijsku Svojину
Industrial Property Agency

RAPORT VJETOR 2025

Adresa: Rruga "Arbënor e Astrit Dehari" nr. 21, 10000 Prishtinë/Republika e Kosovës

Tel: +381 38 200 36 554

Web: www.kipa.rks-gov.net

Përmbajtja

Hyrje	3
1. Pranimi i aplikimeve dhe kërkesave tjera nga palët	4
2. Ekzaminimi i aplikimeve / shqyrtimi i kërkesave	5
3. Kundërshtimet e regjistrimit të markës tregtare	10
4. Publikimi i Buletinit të Agjencisë	10
5. Digjitalizimi i API-së, Sistemi IPAS, WipoScan, WipoPublish, Web faqe	11
6. Aktivitetet për promovimin e pronësisë industriale	12
7. Zhvillimi dhe avancimi i kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të API-së.....	21
8. Bashkëpunimi Ndërkombëtar dhe rajonal	22
9. Të hyrat financiare.....	25
Kontakti	26

Hyrje

Agjencia për Pronësi Industriale (API) është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë për Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti dhe është institucioni i vetëm i ngarkuar në Kosovë për administrimin dhe promovimin e të drejtave të pronësisë industriale, detyrim i cili buron nga neni i 46 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kjo agjenci është pika e vetme shtetërore në Kosovë për mbrojtjen e markave tregtare, patentave, dizajneve industriale, treguesve gjeografikë dhe topografive të produkteve të gjysmëpërçuesve. Përmes proceseve të regjistrimit, API siguron pronarëve të drejtat mbi pronësinë e tyre industriale, duke vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

API ka një rol kyç në zbatimin e Kapitullit VII të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, ku Kosova angazhohet për të mbrojtur dhe zbatuar të drejtat e pronësisë intelektuale. Misioni kryesor i saj është të sigurojë mbrojtjen e pronësisë industriale në territorin e Republikës së Kosovës dhe të promovojë respektimin e kësaj lloji pronësie, duke u bazuar në legjislacionin vendas dhe praktikatat ndërkombëtare.

Në këtë raport vjetor, API paraqet detajet e punës së saj, sfidat me të cilat është përballur dhe përpjekjet për të rritur ndërgjegjësimin publik rreth rëndësisë së pronësisë industriale në Kosovë. Pavarësisht mungesës së stafit të evidentuar edhe në Raportin e Progresit 2025, Agjencia ka arritur performancë maksimale në bazë të kapaciteteve ekzistuese dhe mbetet e përkushtuar të avancojë dhe përmirësojë sistemin e pronësisë industriale në vend, duke përfshirë arritjen e objektivave strategjike.

Agjencia gjatë këtij viti ka fokusuar përpjekjet e saj në përfundimin e shqyrtimit të kundërshtimeve të markave tregtare dhe në zvogëlimin e kohës së regjistrimit të markave tregtare. Këto shërbime kanë pësuar përmirësime të ndjeshme, sipas raportit të mëposhtëm.

Ky raport i detajuar ofron një pasqyrë të hollësishme të lëndëve të pranuar, efikasitetit të stafit të Agjencisë, gamës së shërbimeve të ofruara, si dhe aktiviteteve që janë ndërmarrë për të forcuar kapacitetet administrative dhe promovimin e pronësisë industriale në Kosovë.

Duke ju dëshiruar vit të mbarë

JU FALENDEROJMË


1. Pranimi i aplikimeve dhe kërkesave tjera nga palët

Agjencia për Pronësi Industriale ka vazhduar me angazhimin e saj në pranimin e kërkesave për objekte të pronësisë industriale, përfshirë Markat Tregtare, Patentat, Dizajnet Industriale, kundërshtimet e markave të publikuara, hulumtimet e markave tregtare, ekzaminimet paraprake, vazhdimet e markave tregtare, ndryshimet në regjistër, kërkesat mirëmbajtjen e patentave, dokumentacionet e përparësisë, autorizimet e përgjithshme, ankesat në komisionin e ankesave, vendimet e komisionit të ankesave dhe dokumentacionet tjera.

Në këtë periudhë kohore, në zyrën e pranimin të dokumentacionit të API-së, janë regjistruar **7863** kërkesa të ndryshme. Tabelën e mëposhtme janë pasqyruar kërkesat kryesore:

Tabela e kërkesave të pranuar për vitin 2025	
Marka Tregtare aplikime	2216
Patenta aplikime	8
Dizajn Industriale aplikime	73
Kërkesa për vazhdime të markave tregtare	1047
Kërkesa për ndryshime në regjistër të markave tregtare, patentave dhe dizajneve industriale	822
Kërkesa për plotësime të Markave Tregtare, taksa për lëshimin e vendimit dhe taksa për lëshimin e certifikatës për Marka Tregtare, pagesa të patentave dhe dizajnit industrial	2331
Kundërshtime të Markave Tregtare	79
Kërkesa për mbajtje në fuqi të patentave	89
Dokumente prioriteti	129
Ankesa kundër vendimeve të API-së	33
Autorizime përfaqësimi	98

Tabela 1. Numri i dokumenteve kryesore hyrëse, Janar - Dhjetor 2025




2. Ekzaminimi i aplikimeve / shqyrtimi i kërkesave

Patenta

Numri i aplikimeve për patenta mbetet i ulët, kryesisht për shkak të mungesës së anëtarësimit të Kosovës në Zyrën Evropiane të Patentave (EPO), si dhe për shkak të zhvillimit të kufizuar të industrisë inovative që lidhet drejtpërdrejt me aplikimet për patenta nga shpikësit vendorë. Me anëtarësimin e Kosovës në EPO pritet një rritje e ndjeshme e numrit të aplikimeve, pasi kostot financiare dhe koha e procedurës do të reduktohen në raport me sistemin aktual të mbrojtjes kombëtare. Sipas të dhënave zyrtare të regjistrave të Agjencisë për Pronësi Industriale, deri më tani janë paraqitur gjithsej 2,450 aplikime për patenta.

Për çështjen e ekzaminimit të kërkesave për patenta, ky proces zhvillohet brenda 18 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës. Pas marrjes së patentës, pronari i saj duhet të ofrojë një dëshmi shkrimore që shpikja e tij është e re dhe ka hap shpikës, duke filluar nga fundi i vitit të nëntë të afatit të patentës.



Njoftim për plotësimin e aplikacioneve për patentë	23
Njoftim për pagesën e tarifave për lëshimin e vendimit për njohje	5
Vendim për njohjen e patentës	4
Vendim të tërësishme – pjesërisht të patentave	4
Vendime për ndryshim në regjistër të patentave	3
User doc acceptance, pranimi i mbajtjeve në fuqi pas kontrollimit, dhe i dokumenteve tjera përcjellëse të hyra si user dokumente për aplikimet dhe regjistrin e patentave	73
Vendime për refuzimin e patentave	9

Tabela 2. Statistika vjetore të sektorit të patentave 2025

Marka Tregtare

Agjencia për Pronësi Industriale ka vazhduar me përpunimin dhe shqyrtimin e kërkesave për marka tregtare. Deri tani, shqyrtimet e aplikimeve paraprake janë kompletuar me sukses, dhe puna vazhdon me të njëjtin dinamizëm për të shqyrtuar aplikimet e reja të markave tregtare që janë pranuar gjatë vitit 2025.


Megjithëse me staf të reduktuar, me rritjen e numrit të publikimeve dhe intensifikimin e procesit të ekzaminimit për marka tregtare, është arritur të reduktohet koha mesatare e procedurës së regjistrimit. Bazuar në matjet gjatë vitit 2025, një markë tregtare, në rastet kur procedura zhvillohet pa kundërshtime apo kërkesa për plotësime shtesë, mund të regjistrohet brenda një periudhe prej rreth 8 deri në 10 muajsh.

Deri tek regjistrimi i një marke tregtare e cila nuk pranon kundërshtim gjatë publikimit, Agjencia duhet të ndjekë disa hapa, si: ekzaminimi formal i aplikacionit për markë tregtare, ekzaminimi lidhur me bazat absolute të refuzimit, publikimi i aplikimit, lëshimi i ftesën për pagesën e regjistrimit dhe në fund lëshimi i vendimit dhe certifikatës për regjistrimin e një markë tregtare.

Agjencia ka arritur të zvogëlojë kohën e marrjes së vendimit për regjistrimit të markave tregtare. Tashmë pas pagesës së taksës, vendimi për regjistrim tërhiqet nga pala mbrenda 1 jave. Për markën me numër regjistrimi 20000 janë dashur 6 muaj të procedohet me vendimin pas pagesës, ndërsa për markën tregtare me numër regjistrimi 36149 janë dashur 5 ditë pune.

Ky përmirësim ka ardhur si rezultat i intensifikimit të procesit të ekzaminimit të aplikimeve për marka tregtare, përfshirë rritjen e numrit të ekzaminimeve dhe ftesave për pagesën e tarifës së regjistrimit

gjatë vitit 2025. Ky trend reflektohet qartë edhe në grafikonin e mëposhtëm, i cili dëshmon ndikimin e drejtpërdrejtë të rritjes së efikasitetit operacional në uljen e kohës së nxjerrjes së vendimeve përfundimtare.



Vendime për regjistrimin e markave tregtare	1700
Publikime të markave tregtare pas ekzaminimit	2172
Njoftime për plotësimin e aplikacioneve	6
Njoftime për heqje dorë të markave tregtare	32
Vendime për ndryshimin në regjistër të markave tregtare dhe përfaqësuesve të autorizuar	774
Njoftime për ndryshime të përfaqësuesit	186
Vendime për vazhdimin e markave tregtare	1000
Lëshimi i certifikatave për marka tregtare	1604
Ftesë për pagesën e vendimit për markë tregtare	2192
Vendime për zgjidhjen e kundërshtimeve	76
Ekstrakte regjistri	42
Vendime për refuzimin e MT	11
Ftesa për përgjigje në kundërshtimin e markave tregtare, shfuqizimeve dhe revokimeve	63

Tabela 3. Statistika vjetore të sektorit të markave tregtare për vitin 2025

Grafikoni i mëposhtëm paraqet numrin e ekzaminimeve të aplikimeve për marka tregtare në vite. Në krahasim me vitin 2024, gjatë vitit 2025 është shënuar një rritje **prej 17.78%** e numrit të ekzaminimeve të markave tregtare, e cila është shoqëruar edhe me rritje të numrit të ftesave për pagesën e tarifës së regjistrimit për **21.23%** dhe rritjen e numrit të buletineve për **25%**. Ky

intensifikim i trajtimit të lëndëve ka ndikuar drejtpërdrejt në **uljen e kohës së regjistrimit të markave tregtare**, duke përmirësuar efikasitetin e përgjithshëm të procesit dhe përsheptuar nxjerrjen e vendimeve përfundimtare.




Dizajni Industrial

Numri i aplikimeve për dizajne industriale në Kosovë mbetet dukshëm i ulët, gjë që lidhet drejtpërdrejt me nivelin ende të kufizuar të zhvillimit industrial dhe kreativ në vend. Deri më tani, sipas të dhënave të regjistrave të Agjencisë për Pronësi Industriale, janë paraqitur gjithsej 498 aplikime për dizajne industriale. Mungesa e kapaciteteve për zhvillimin dhe komercializimin e produkteve të reja, si dhe niveli i ulët i ndërgjegjësimit mbi rëndësinë ekonomike të dizajnit industrial, ndikojnë negativisht në kërkesën për këtë formë mbrojtjeje.

Njoftime për plotësimin e Dizajnit Industrial	39
Vendime për vazhdimin e Dizajnit Industrial dhe ndryshimin në regjistër	15
Vendime për regjistrimin e Dizajnit Industrial	25
Certifikata për Dizajnin Industrial	1
Ftese për pagesën e regjistrimit të Dizajnit Industrial	32
Vendime për ndryshime në regjistër	2

Tabela 4. Statistika vjetore të dizajnit industrial 2025



Përmbledhja statistikore e punës vjetore

Pavarësisht kapaciteteve të kufizuara njerëzore — të cilat edhe në Raportin e Progresit 2025 theksohen si sfidë, me vlerësimin se “Agjencia e Pronësisë Industriale mbetet me mungesë stafi” — Agjencia për Pronësi Industriale ka arritur të demonstrojë performancë maksimale në bazë të kapaciteteve ekzistuese. Gjatë vitit 2025, API ka ruajtur efikasitet të lartë dhe ka realizuar në mënyrë të rregullt dhe sistematike të gjitha veprimet procedurale në sistemin IPAS, duke përmbushur detyrat thelbësore pavarësisht kufizimeve të burimeve njerëzore.

Bazuar në të dhënat statistikore të sistemit, gjatë vitit 2025 zyrtarët e API-së kanë kryer gjithsej 28235 hapa procedurorë – ku secili hap nënkupton kalimin nga një fazë e ekzaminimit në tjetrën, çka dëshmon intensitet të lartë pune dhe menaxhim të qëndrueshëm të fluksit administrativ.

Digjitalizimi i procesit administrativ ka qenë një tjetër arritje e dukshme. Gjatë vitit raportues janë skanuar, indeksuar dhe dërguar në server gjithsej 15326 shkresa hyrëse dhe dalëse, duke siguruar qasje të shpejtë dhe të sigurt në dokumentacionin elektronik dhe duke lehtësuar dukshëm procedurën e pranimit dhe lëshimit të dokumenteve.

Për më tepër, Agjencia ka lëshuar 7746 dokumente dalëse, përfshirë vendime, certifikata, njoftime dhe ftesa procedurale, të cilat kanë mundësuar përfundimin me sukses të proceseve të shqyrtimit të aplikimeve. Ky volum i lartë i prodhimeve administrative konfirmon faktin se API ka arritur të ruajë ritmin dhe cilësinë e shërbimeve pavarësisht numrit të reduktuar të stafit, duke reflektuar nivele të larta të përkushtimit profesional dhe efikasitetit operacional.

3. Kundërshtimet e regjistrimit të markës tregtare

Shqyrtimi i kërkesave për kundërshtimin e markave tregtare ka vazhduar me intensitet edhe gjatë vitit 2025, pavarësisht kapaciteteve të kufizuara njerëzore. Aktualisht, vetëm një zyrtar është i ngarkuar me trajtimin e këtyre procedurave, i cili njëkohësisht është i angazhuar edhe në procesin e digjitalizimit të të dhënave, përfshirë skanimin dhe indeksimin e lëndëve hyrëse. Kjo ngarkesë e dyfishtë pune e bën procesin veçanërisht sfidues, duke marrë parasysh kompleksitetin ligjor dhe procedural të kundërshtimeve në fushën e markave tregtare.

Megjithatë, edhe në këto kushte të kufizuara, Agjencia ka arritur të sigurojë vazhdimësi në shqyrtimin e lëndëve, duke dëshmuar efikasitet të lartë, fleksibilitet profesional dhe menaxhim racional të burimeve ekzistuese. Gjatë vitit 2025 ka filluar shqyrtimi i përgjigjeve në kundërshtimet e paraqitura për aplikimet e markave tregtare të pranuar gjatë vitit 2024, përjashtuar rastet që janë subjekt i procedurave gjyqësore dhe që, në përputhje me dispozitat e Udhëzimit Administrativ përkatës, mbeten të pezulluara.

Njëkohësisht, Agjencia ka përfunduar një pjesë të konsiderueshme të kundërshtimeve të pranuar gjatë vitit 2025 dhe ka vazhduar trajtimin e rasteve të mbetura, duke synuar ruajtjen e standardeve profesionale dhe ligjore në procesin e vendimmarrjes, si dhe mbrojtjen e të drejtave të palëve në procedurë.

4. Publikimi i Buletinit të Agjencisë

Gjatë vitit raportues, Agjencia për Pronësi Industriale ka demonstruar një nivel të lartë transparence dhe funksionaliteti administrativ, duke publikuar gjithsej 10 Buletine Zyrtare. Ky rezultat përfaqëson një rritje prej 25% të numrit të buletineve të publikuara krahasuar me vitin paraprak, çka ka ndikuar drejtpërdrejt në zvogëlimin e kohës së regjistrimit të objekteve të pronësisë industriale, me theks të veçantë në markat tregtare.

Në këto buletine janë përfshirë gjithsej 6082 objekte të pronësisë industriale, të cilat përfshijnë:

- aplikime për marka tregtare,
- vendime për regjistrimin e markave tregtare,
- ndryshime dhe vazhdime në regjistër,
- regjistrime të patentave,
- regjistrime të dizajnit industrial.

Në përputhje me nenin 34 të Ligjit për Marka Tregtare Nr. 08/L-075, mbajtësit e markave të mëparshme kanë të drejtë të paraqesin kundërshtimet e tyre ndaj aplikimeve të publikuara. Afati

ligjor për dorëzimin e kundërshtimeve është gjatë periudhës sa Buletini Zyrtar është i hapur për kundërshtime ose brenda 3 muajve nga data e publikimit së tij.

Përveç Buletinit, Agjencia siguron transparencë dhe akses publik përmes Regjistrat Online të Pronësisë Industriale, të publikuar në faqen zyrtare të internetit. Ky sistem u mundëson:

- qytetarëve dhe publikut të gjerë të kërkojnë informacione mbi objektet e regjistruara të pronësisë industriale, si dhe
- aplikuesve të monitorojnë në kohë reale ecurinë e shqyrtimit të aplikacionit të tyre.

Linku për qasje në Buletinet Zyrtare të Agjencisë <https://kipa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,47>



5. Digjitalizimi i API-së, Sistemi IPAS, WipoScan, WipoPublish, Web faqe

Në lidhje me digjitalizimin dhe avancimin e sistemit IPAS, Agjencia ka zhvilluar disa takime dhe trajnime online me WIPO-n, gjatë të cilave janë realizuar testimet e para të sistemit të ri IPAS 4.0. Stafi i Agjencisë për Pronësi Industriale është trajnuar për përdorimin e këtij sistemi, ndërsa kalimi në sistemin e ri është planifikuar të realizohet gjatë vitit 2026.

Kalimi në sistemin e ri IPAS 4.0 do të krijojë bazën për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve digjitale, duke mundësuar në vitet në vijim kalimin në sistemin online të pranimit të aplikacioneve për objektet e pronësisë industriale. Me sistemin e ri parashihet gjithashtu përditësim më i saktë dhe më i rregullt i të dhënave në regjistrin online të pronësisë industriale, duke u mundësuar palëve që në kohë reale të përcjellin statusin e lëndëve të tyre.

Gjatë vitit 2026, API do të përgatisë planin e implementimit për platformën elektronike të aplikimeve për pronësi industriale. Ky plan do të ofrojë një pasqyrë të qartë të infrastrukturës ekzistuese dhe të nevojave zhvillimore, me qëllim funksionalizimin e plotë të aplikimeve online. Aplikimet elektronike do të reduktojnë ndjeshëm kontaktin fizik me palët dhe do të lehtësojnë qasjen në shërbimet e Agjencisë.

API gjatë vitit 2025 ka publikuar në ueb-faqen e saj zyrtare (<https://kipa.rks-gov.net/>) aktivitetet kryesore institucionale, duke krijuar gjithsej **30 lajme**, me qëllim informimin e rregullt dhe transparent të publikut.

Për informimin e publikut për pronësinë intelektuale, është aktive dhe web faqja në të cilën janë të përmbledhura të gjitha informatat mbi pronësinë intelektuale, <https://www.pronesiintelektuale.com/>.

6. Aktivitetet për promovimin e pronësisë industriale

Agjencia për Pronësi Industriale (API) mori pjesë në takimin e organizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përkatësisht Departamenti i Industrisë, në bashkëpunim me Drejtoritë e Zhvillimit Ekonomik të Komunave të Rajonit të Ferizajit. API foli për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, regjistrimin e markave, patentave dhe dizajneve industriale.



Agjencia për Pronësi Industriale në bashkëpunim me Doganën e Kosovës mori pjesë në trajnimin e doganierëve të rinj, si pjesë e planit të saj për ngritjen e kapaciteteve të organeve ligj zbatuese. API ligjëroi mbi pronësisë industriale. Agjencia mori pjesë në trajnimin e 2 grupeve të kadetëve.



Agjencia për Pronësi Industriale (API) mori pjesë në takimin e organizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përkatësisht Departamenti i Industrisë, në bashkëpunim me Drejtoritë e Zhvillimit Ekonomik të Komunave të Rajonit të Gjakovës. API foli për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, regjistrimin e markave, patentave dhe dizajneve industriale.



Me qëllim të ngritjes së vetëdijes së gjeneratave të reja për rëndësinë e mbrojtjes së pronësisë intelektuale, përfaqësues nga Agjencia për Pronësi Industriale, Dogana e Kosovës dhe Zyra për të Drejtat e Autorit realizuan një vizitë informuese në shkollën "Princeton School of Prishtina". Gjatë këtij aktiviteti, nxënësit u informuan mbi rëndësinë e markave tregtare, patentave, dizajneve

industriale, të drejtave të autorit dhe mënyrën se si këto të drejta mbrojnë krijimtarinë, inovacionin dhe ekonominë kreative.



Më 16 prill 2024, në ambientet e Kolegjit UBT, u mbajt takimi me temën “Inovacioni dhe Mbrojtja e Pronësisë Intelektuale”, një ngjarje me rëndësi për studentët dhe profesionistët e fushave të teknologjisë, inxhinierisë dhe biznesit, e cila kishte për qëllim ngritjen e vetëdijes dhe thellimin e njohurive mbi mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale. Agjencia për Pronësi Industriale prezantoi rolin e saj në mbrojtjen e inovacioneve, patentave, dizajneve industriale dhe markave tregtare, duke theksuar rëndësinë e këtyre mjeteve ligjore për sektorët e teknologjisë dhe biznesit.



Agjencia për Pronësi Industriale, në bashkëpunim me ITP Prizren, Zyrën për të Drejtat e Autorit dhe Doganën e Kosovës, organizoi një takim informues me temën “Inovacioni dhe Mbrojtja e Pronësisë Intelektuale”, i cili u mbajt në ambientet e ITP Prizren.



Agjencia për Pronësi Industriale (API) mori pjesë në takimin e organizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përkatësisht Departamenti i Industrisë, në bashkëpunim me Drejtoritë e Zhvillimit Ekonomik të Komunave të Rajonit të Pejës. API foli për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, regjistrimin e markave, patentave dhe dizajnëve industriale.



Me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë organizoi një sesion informativ me temën "Nga Krijimtaria në Kapital: Roli i Pronësisë Intelektuale në Rritjen dhe Zhvillimin e Biznesit."



Më 23 prill 2025, në objektet e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, Ndërtimtarisë dhe atij të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, u mbajt ligjërata me temën "Inovacioni dhe Mbrojtja e Pronësisë Intelektuale", në praninë e studentëve, profesorëve dhe përfaqësuesve institucionalë, ku Agjencia për Pronësi Industriale prezantoi procesin dhe rëndësinë e mbrojtjes së patentave dhe dizajneve industriale.



Me qëllim të ngritjes së vetëdijes së gjeneratave të reja për rëndësinë e mbrojtjes së pronësisë intelektuale, përfaqësues nga Agjencia për Pronësi Industriale, Dogana e Kosovës dhe Zyra për të Drejtat e Autorit realizuan një vizitë informuese në shkollën New York School of Science in Kosova.



Studentët e Fakultetit Juridik u njohën me sistemin e mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale në Kosovë, ku Agjencia për Pronësi Industriale ligjëroi mbi objektet e pronësisë industriale dhe regjistrimin e këtyre të drejtave.



Në kuadër të shënimit të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale 2025, Agjencia për Pronësi Industriale (API), në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Doganën e Kosovës, organizoi Konferencën me temën "Pronësia Intelektuale dhe Muzika"



Agjencia për Pronësi Industriale (API) mori pjesë në takimin e organizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përkatësisht Departamenti i Industrisë, në bashkëpunim me Drejtoritë e Zhvillimit Ekonomik të Komunave të Rajonit të Prishtinës. API foli për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, regjistrimin e markave, patentave dhe dizajnëve industriale.



Më 26 prill 2025, në ambientet e Kolegjit AAB, u mbajt ligjërata me temën “Mbrojtja e Pronësisë Intelektuale në Kosovë”, e organizuar në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për këtë fushë. Agjencia prezantoi rëndësinë e mbrojtjes së inovacioneve, patentave, dizajneve dhe markave tregtare, dhe rolin e Agjencisë në regjistrimin e këtyre të drejtave.



Agjencia për Pronësi Industriale (API) mori pjesë në takimin e organizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përkatësisht Departamenti i Industrisë, në bashkëpunim me Drejtoritë e Zhvillimit Ekonomik të Komunave të Rajonit të Mitrovicës. API foli për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, regjistrimin e markave, patentave dhe dizajneve industriale.



Agjencia për Pronësi Industriale (API) mori pjesë në takimin e organizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përkatësisht Departamenti i Industrisë, në bashkëpunim me Drejtoritë e Zhvillimit Ekonomik të Komunave të Rajonit të Gjilanit. API foli për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, regjistrimin e markave, patentave dhe dizajnëve industriale.



Agjencia për Pronësi Industriale (API) mori pjesë në takimin e organizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përkatësisht Departamenti i Industrisë, në bashkëpunim me Drejtoritë e Zhvillimit Ekonomik të Komunave të Rajonit të Prizrenit. API foli për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, regjistrimin e markave, patentave dhe dizajnëve industriale.



Agjencia për Pronësi Industriale, si pjesë e Task Forcës kundër Piraterisë, mori pjesë në punëtorinë e organizuar me përfaqësuesit e institucioneve zbatuese të ligjit, ku u diskutua mbi temat kyçe të

pronësisë intelektuale. Në këtë aktivitet, ku morën pjesë përfaqësues nga Dogana e Kosovës, Policia e Kosovës dhe Inspektorati i Tregut, Agjencia prezantoi konceptet bazë dhe mekanizmat e mbrojtjes së pronësisë industriale, si dhe rolin e saj në identifikimin dhe parandalimin e shkeljeve në treg.



7. Zhvillimi dhe avancimi i kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të API-së

Për shkak të mungesës së anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare të pronësisë industriale (të tilla si WIPO, EUIPO, EPO), Agjencia ka pasur mundësi të kufizuara për të siguruar pjesëmarrje të gjerë në trajnime ndërkombëtare apo konferenca. Megjithatë, në kuadër të mundësive të ofruara përmes bashkëpunimeve rajonale dhe iniciativave të partnerëve ndërkombëtarë, Agjencia ka marrë pjesë në një numër të kufizuar, por të rëndësishëm aktiviteteve profesionale, me qëllim forcimin gradual të kapaciteteve teknike dhe administrative të stafit:

- Në Janar dhe Nëntor është realizuar trajnimi i zyrtarëve të API-së në Entit Shtetëror të Pronësisë Industriale të Maqedonisë së Veriut. Zyrtarët u trajnuan për forcimin e kapaciteteve të tyre në fushën e markave tregtare.
- Me datat 26–27 maj 2025, në Shkup u mbajt ngjarja rajonale “Western Balkan GI Practitioners Network 2025 Regional Encounters”, me temën Treguesit Gjeografikë: Trashëgimi e Përbashkët, Cilësi e Certifikuar – Lidhja mes Komuniteteve Rurale dhe Konsumatorëve. Ky takim mbledhi përfaqësues nga institucionet përkatëse, organizata ndërkombëtare dhe prakticienë të treguesve gjeografikë nga i gjithë Ballkani Perëndimor. Agjencia për Pronësi Industriale mori pjesë në këtë Takim Rajonal për Treguesit Gjeografikë në Shkup.



- Agjencia mori pjesë në trajnimin e WIPO-s “Educator Certification Training – STEM, Innovation, Entrepreneurship & IP Education”, të organizuar në Tiranë më 24–26 shtator 2025, në bashkëpunim me Drejtorinë e Pronësisë Industriale të Republikës së Shqipërisë. Qëllimi: rritja e kapaciteteve administrative të zyrtareve të API-së dhe e Komisionit të Ankesave. Rezultate: përmirësim i praktikave të analizës/vendimmarrjes dhe mjete praktike për edukim e vetëdijesim në pronësi industriale.

8. Bashkëpunimi Ndërkombëtar dhe rajonal

CEFTA

Agjencia për Pronësi Industriale mori pjesë në takimin e parë të Nënkomitetit të CEFTA-s për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale (IPR), i mbajtur në Budva, Mal i Zi, në kuadër të zbatimit të Vendimit të Komitetit të Përbashkët Nr. 5/2024 për aspektet tregtare të pronësisë intelektuale. Ky takim shënon një hap të rëndësishëm drejt rritjes së rolit të pronësisë intelektuale si motor i inovacionit, konkurrueshmërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm në rajon, si dhe përforcon rolin e API-së në proceset rajonale të harmonizimit dhe bashkëpunimit teknik.

Agjencia për Pronësi Industriale do ta përfaqësojë Republikën e Kosovës në Nënkomitetin e CEFTA-s për Pronësinë Intelektuale, duke kontribuar në harmonizimin rajonal dhe forcimin e mbrojtjes së të drejtave të PI-së.

Swiss PartnersHIP – Intellectual Property Cooperation Programme, Kosovo

Gjatë vitit 2025, Agjencia për Pronësi Industriale ka zhvilluar disa takime pune dhe vizita koordinuese me partnerët zviceranë për finalizimin e projektit Swiss PartnersHIP Kosovo, i cili pritet të fillojë zyrtarisht gjatë vitit 2026. Projekti është pjesë e Swiss PartnersHIP Programme, një program ndërkombëtar i mbështetur nga SECO dhe i implementuar nga Instituti Federal Zviceran i Pronësisë Intelektuale (IPI).

Qëllimi i përgjithshëm i programit është përmirësimi i sistemit të pronësisë intelektuale, nxitja e inovacionit dhe mbështetja e zhvillimit socio-ekonomik në vendet partnere të Zvicrës. Për Kosovën, projekti ka një buxhet prej 700,000 CHF dhe një kohëzgjatje 4-vjeçare.

Projekti do të zbatohet nga IPI në bashkëpunim të ngushtë me partnerët vendës, me fokus të veçantë te Agjencia për Pronësi Industriale si institucioni kryesor kosovar për koordinimin e aktiviteteve dhe objektivave të projektit. Programi do të përfshijë tri komponentë kryesore:

- Forcimi i ekosistemit të inovacionit;
- Rritja e kapaciteteve institucionale të agjencive të zbatimit (Dogana dhe e drejta e autorit);
- Promovimi i mbrojtjes së PI-së dhe rritja e vlerës së shtuar për produktet bujqësore.

Ky projekt paraqet një mundësi të rëndësishme për avancimin e mëtejshëm të sistemit të pronësisë industriale në Kosovë dhe për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë strategjike.

Zyra Austriake e Patentave

Gjatë vitit 2025, Agjencia për Pronësi Industriale ka shënuar një arritje të rëndësishme në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, përmes dakordimit në parim për lidhjen e një Memorandumi Mirëkuptimi me Zyrën Austriake të Patentave. Ky dakordim është rezultat i takimeve dhe konsultimeve të zhvilluara ndërmjet dy institucioneve, me fokus të veçantë në ekzaminimin substancial të aplikimeve për patenta.

Marrëveshja e propozuar synon të krijojë një kornizë bashkëpunimi teknik, përmes së cilës API do të ketë mundësinë të ofrojë për herë të parë shërbimin e ekzaminimit substancial të patentave, duke u mbështetur në ekspertizën e një autoriteti të njohur ndërkombëtarisht. Kjo përbën një hap të rëndësishëm drejt rritjes së cilësisë së shqyrtimit të patentave, forcimit të sigurisë juridike për inovatorët vendorë dhe përafrimit të praktikave të API-së me standardet ndërkombëtare.

Po ashtu, bashkëpunimi parashikon edhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit të API-së, përmes trajnimeve, shkëmbimit të praktikave më të mira dhe përfshirjes në aktivitete të përbashkëta teknike. Draft-marrëveshja është proceduar për konsultime dhe miratime të brendshme dhe ndërinstytucionale, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, me synimin që bashkëpunimi të formalizohet dhe operacionalizohet në fazën pasuese.

Takimet me zyret rajonale të pronësisë industriale

Gjatë vitit 2025, Agjencia për Pronësi Industriale organizoi një takim pune me Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale të Republikës së Shqipërisë, ndërsa Enti Shtetëror për Pronësi Industriale i Republikës së Maqedonisë së Veriut mori pjesë në drekën zyrtare të organizuar me këtë rast, duke kontribuar në forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e pronësisë industriale.

Takimi konfirmoi përkushtimin e institucioneve për thellimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e pronësisë industriale, harmonizimin me standardet evropiane dhe avancimin e kapaciteteve institucionale në shërbim të inovacionit dhe zhvillimit ekonomik.



9. Të hyrat financiare

Agjencia realizon të hyra të cilat gjatë kësaj periudhe raportuese kanë qenë në shumën **367,929.00** euro. Për realizimin e këtyre të hyrave janë gjeneruar 6996 fletëpagesa. API ka sistemin e saj online të gjenerimit të fletëpagesave përmes web faqes së saj, ky shërbim ka mundësuar zvogëlimin e kohës për aplikimin dhe qasje në shërbimet e API-së.



Kontakti



Agjencia për Pronësi Industriale
Agencija za Industrijsku Svojину
Industrial Property Agency

MINISTRIA E INDUSTRIË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË

Adresa: Rruga "Arbënor e Astrit Dehari" nr. 21, 10000 Prishtinë / Republika e Kosovës

Website: www.kipa.rks-gov.net

E-mail: infoapi@rks-gov.net

Tel: +383 38 200 36 554

Orari i pritjes: E hënë – E premte 08:30 - 15:30